



INSTITUTI I KURRIKULËS DHE TRAJNIMIT

PROGRAMET E KURRIKULËS BËRTHAMË TË GJIMNAZIT

FUSHA: ARTE

LËNDA: MUZIKË

KODI: 1.3

PROGRAMET E LËNDËS MUZIKË PËR KLASAT 10-12

TIRANË, SHTATOR 2008

Lënda e muzikës në gjimnaz është pjesë domethënëse e kulturës njerëzore, e cila zë një hapësirë shumë të rëndësishme dhe një ndikim shumë të madh në krijimin e gjendjeve të ndryshme emocionale tek njeriu. Në të gjitha kohërat, muzika është konsideruar pjesë e pandarë e formimit, e pasurisë shpirtërore dhe e kulturimit individual të njeriut.

Kjo përmbajtje mësimore do të përqendrohet mbi përvojat muzikore të vetë nxënësve si dhe në krijimtarinë që ata do të sjellin, duke bashkëvepruar aftësitë e fituara edhe me përvoja të tjera artistike. Njohja, realizimi dhe vlerësimi i muzikës nga të gjithë nxënësit zhvillon më tej jo vetëm anën kulturore, por edhe aftësitë shoqërore dhe komunikuese të nxënësve.

Si një lëndë brenda fushës së arteve që zhvillohet në gjimnaz, muzika luan një rol shumë të rëndësishëm në kontributin dhe zhvillimin e veprimtarive kulturore dhe artistike të shkollës. Ajo merr një rëndësi të veçantë në organizimin dhe zhvillimin e festivaleve apo ngjarjeve të tjera artistike që do të përcaktojnë shkolla, ku aftësitë performuese në këto veprimtari jo vetëm ato muzikore, por edhe të lëndëve të tjera në fushën e arteve (art pamor, teatër dhe kërcim), do të konsolidojnë edhe më shumë njohuritë e nxënësve për kulturën e tyre, kulturat e krahinave të tjera dhe më gjerë në rajon. Zhvillimi i kësaj lënde do t'i ndihmojë ata të vlerësojnë diversitetin e kulturave muzikore, duke kuptuar bashkëveprimin e kulturave dhe formave të artit midis njëra – tjetrës.

Gjithashtu, kjo lëndë kërkon që përmes studimit të përmbajtjes që ajo ofron, të mundësojë *zhvillimin personal* të nxënësve, ku ata të shohin veten e tyre si pjesë e shoqërisë dhe kontribues aktivë në të, si dhe të *përgatisë nxënësit si qytetarë aktivë të një shoqërie evropiane*.

1. SYNIMI I LËNDËS

Ky program synon:

Të edukojë nxënësit nga pikëpamja estetike dhe muzikore, duke i orientuar ata në mënyrë të saktë drejt kuptimit të vlerave estetike dhe veçorive të ligjërit muzikor nga abstraktja te konkretja, në njohjen me gjinitë dhe llojet e ndryshme të muzikës, si dhe duke u njohur me zhvillimin historik të muzikës në kontekste dhe kultura të ndryshme.

2. OBJEKTIVAT E PËRGJITHSHËM

Në përfundim të këtij programi nxënës/i, - ja:

- të zhvillojë aftësitë për të dëgjuar muzikë, duke interpretuar vlerat e veprës muzikore që dëgjon;
- të analizojë zhvillimin e historisë së muzikës në periudha dhe kontekste të ndryshme kulturore me veçoritë e tyre përkatëse;

- të kuptojë domethënien e muzikës përmes tingujve dhe mediave të ndryshme (CD, DVD, TV, kompjuter);
- të përdorë programe kompjuterike për shkrimin muzikor;
- të zhvillojë aftësitë e të menduarit kritik dhe krijues gjatë procesit të dëgjimit muzikor;
- të shikojë muzikën si mjet për të zhvilluar profesionin e tyre në të ardhmen.

3. OBJEKTIVA SIPAS LINJAVE

54 javë x 1 orë = 54 orë

Linja: Estetika e arteve dhe aspektet muzikore ¹

Përshkrimi i linjës: Kjo linjë ka për qëllim njohë nxënësit me disa ligje të përgjithshme të estetikës që karakterizojnë artin në përgjithësi dhe krijimtarinë artistike dhe muzikore në veçanti. Nxënësit njihen me objektin e artit, kategoritë estetike, klasifikimin e arteve muzikë, art pamor, kërcim dhe teatër dhe lidhjen e tyre me njëri-tjetrin. Këto ligje të përgjithshme të artit dhe specifika e tij në raport me veprimtari të tjera të njeriut dhe shoqërisë, shërbejnë si urë për të kaluar në njohjen e secilit lloj arti individualisht.

Orët e sugjeruara:² 5

Linja	Objektiva
Estetika e arteve dhe aspektet muzikore	<p>Në përfundim të këtij programi nxënës/i,-ja:</p> <ul style="list-style-type: none"> • të shpjegojë artet si pjesë e objektit të <i>estetikës</i>; • të dallojë konkretisht <i>cilësitë estetike</i> në një vepër arti (muzikë, teatër, art pamor dhe kërcim); • të klasifikojë artet: muzikë, art pamor, kërcim dhe teatër, sipas <i>mjeteve të tyre shprehëse</i>;

1. Estetika do të zhvillohet nga përdoruesit e programit (mësuesit dhe autorët e teksteve si një linjë e përbashkët, *nëse do të jetë një tekst për të katër lëndët*, pasi edhe çështjet e vendosura si kërkesë për studim janë të njëjta, duke veçuar vetëm klasifikimin e arteve sipas mjeteve të tyre shprehëse). Orët e estetikës, pikërisht në objektivat me përmbajtje të përbashkët, realizohen në mënyrë të përbashkët për të dyja lëndët. Edhe objektivat që lidhen specifikisht me lëndën e zgjedhur do të shpjegohen dhe realizohen në mënyrë të përbashkët për të dyja lëndët. Orët e mbledhura për të dyja lëndët e përzgjedhura janë 10 orë, nga të cilat 4 orë mund të përdoren për shpjegimin e kuptimit të përgjithshëm të estetikës për të gjitha artet dhe 6 orët e mbetura mund të planifikohen sipas specifikeve estetike të lëndës së përzgjedhur (3+3).

² Orët e sugjeruara janë orët e planifikuara nga specialistët për zhvillimin e linjës. Shuma totale e orëve të linjave duhet të jetë sa numri i plotë i orëve në planin mësuesor për këtë lëndë. Quhen të sugjeruara sepse i jepet liri zbatuesit të programit (mësuesi/ja) që të shtojë ose të pakësojë numrin e sugjeruar të orëve në masën 10 % sipas nevojave të klasës.

	<ul style="list-style-type: none"> • të përshkruajë dallimin ndërmjet <i>arteve të thjeshta</i> dhe <i>arteve të përbëra</i>; • të përshkruajë <i>lidhjet e llojeve të ndryshme të arteve me njëri – tjetrin</i>; • të përshkruajë <i>ndryshimin e shijeve estetike muzikore, duke u nisur nga krahasimi i dy veprave të periudhave të ndryshme</i>; • të argumentojë <i>parapëlqimet e veta artistike në grup, familje etj., si: (p.sh. pse i pëlqen një muzikë e periudhës së klasicizmit nga një muzikë e shek. 20)</i>; • të shkruajë një ese ose artikull kritik mbi vlerat estetike të një veprë arti, të një periudhe të caktuar. • të shpjegojë <i>rrugët përmes të cilave duhet të orientohet për të parë një shfaqje artistike p.sh.: llojin e shfaqjes, ku dhe kur zhvillohet, rregullat para, gjatë dhe pas shfaqjes etj.</i>
--	---

Linja 2: Elementet dhe parimet e muzikës

Përshkrimi i linjës: Kjo linjë prezanton *elementet dhe parimet* muzikore, ku nëpërmjet tyre, nxënësit kuptojnë ndërtimin e një pjese muzikore si dhe gjejnë elementet e përbashkëta që bashkojnë artet me njëri- tjetrin, si: forma, ritmi, koha, harmonia, hapësira etj. Elementet muzikore dhe parimet e formësimit muzikor, nxënësit do t'i gjejnë të pasqyruar edhe në lloje të ndryshme muzikore si p.sh: këngë, minuet, muzikë moderne etj. Njohja me to do t'i ndihmojnë nxënësit për të analizuar një pjesë muzikore pavarësisht nga lloji dhe gjinia.

Orët e sugjeruara: 4

Linja	Objektiva
Elementet dhe parimet e muzikës	<p>Në përfundim të këtij programi nxënës/i,-ja:</p> <ul style="list-style-type: none"> • të evidentojë <i>elementet muzikore</i> në një vepër konkrete muzikore dhe parimet e ndërtimit të saj, si p.sh.: këngë, minuet etj.; • të shpjegojë rolin e mjeteve <i>shprehëse muzikore</i>, bazë për kuptimin dhe realizimin e një veprë muzikore; • të shpjegojë <i>parimet e formësimit të muzikës</i> që kanë të bëjnë me gjininë (vokale/instrumentale) dhe stilin muzikor; • të shpjegojë ndërtimin e formave të thjeshta 1, 2, 3 pjesësh dhe parimet e zhvillimit në gjini të ndryshme muzikore, duke i evidentuar ato gjatë dëgjimit; • të përdorë elementet muzikore, gjatë analizës së një pjese muzikore pavarësisht nga lloji dhe gjinia.

Linja 3: Procese të realizimit muzikor

Përshkrimi i linjës: Kjo linjë zhvillon aftësitë e nxënësve për të analizuar vepra të ndryshme muzikore, duke kuptuar se si janë të ndërtuara ato. Gjithashtu, disa forma të caktuara muzikore kanë një rol të caktuar në jetën artistike dhe shoqërore të një vendi. Dëgjimi, interpretimi dhe vlerësimi i veprave të ndryshme muzikore i aftëson nxënësit për të dalluar muzikën diletante nga ajo profesionale.

Orët e sugjeruara: 6

Linja	Objektiva
Procese të realizimit muzikor	<p>Në përfundim të këtij programi nxënës/i,-ja:</p> <ul style="list-style-type: none">• të shpjegojë <i>rolin</i> e disa formave muzikore të caktuara në jetën e përditshme (p.sh himni kombëtar apo marshet);• të analizojë (pas dëgjimit) dy pjesë të të njëjtës periudhë që janë shkruar në të njëjtin lloj apo gjini (<i>sonatë për piano apo koncerti për violinë</i>), nga kompozitorë të ndryshëm, duke renditur dy-tri karakteristika muzikore;• të zhvillojë të dëgjuarin me vëmendje të argumentimit të të tjerëve rreth një muzike të caktuar (moderne apo klasike), duke mos paragjykuar opinionet e tyre;• të krahasojë dy shembuj muzikorë <i>live</i> dhe dy shembuj të regjistruar, të llojit klasik apo modern, duke shprehur ndjeshmërinë dhe emocionet e përjetura;• të shpjegojë si <i>komponentët përbërës</i> në një shfaqje muzikore (skenografia, muzika, kostumet, dritat etj.), janë domethënëse në realizimin me sukses apo jo të saj;• të përdorë një terminologji muzikore për të shprehur ndjenjat dhe emocionet që i krijon një vepër muzikore, si p.sh.: kur dëgjon një opera, një këngë të muzikës së lehtë etj.

Linja 4: Historia e muzikës, bota dhe shoqëria

Përshkrimi i linjës: Kjo linjë njih nxënësit me zhvillimin e muzikës në periudha të ndryshme, duke shpjeguar ndikimet dhe karakteristikat e saj historike, shoqërore dhe kulturore në këto periudha. Kjo linjë sjell jo vetëm zhvillimin kronologjik të historisë së muzikës, por zhvillon aftësitë e nxënësve për të ndërthurur zhvillimin historik të muzikës dhe interpretimin e saj, përmes përdorimit të gjykimeve artistike, elementeve estetike dhe interpretimit të vlerave muzikore. Nxënësit aftësohen gjithashtu, për të zhvilluar përgjigjet e tyre emocionale ndaj muzikës që ata dëgjojnë, qoftë kjo tradicionale, klasike apo moderne, përmes një procesi gjykues kritik pozitiv, komunikimit dhe përdorimit të

një gjuhë të thjeshtë muzikore. Një vend të veçantë zë edhe njohja me muzikën dhe përfaqësuesit e saj, të huaj apo shqiptarë në periudha të ndryshme.

Orët e sugjeruara: 29

Linja	Objektiva
<p>Historia e muzikës, bota dhe shoqëria</p>	<p>Në përfundim të këtij programi nxënës/i,-ja:</p> <ul style="list-style-type: none"> • të klasifikojë zhvillimet e muzikës në shoqërinë njerëzore në periudha të ndryshme historike, prej lashtësisë deri në ditët e sotme (lashtësi, mesjetë, Rilindje, Romantizëm, moderne), duke u mbështetur në karakteristikat specifike, historike, stilistike dhe estetike të veprave më të spikatura; • të përshkruajë muzikën në: <ul style="list-style-type: none"> - Mesjetë (shek. XI – XIV) - këngët gregoriane dhe shkrimi muzikor – përfaqësuesit kryesorë. - Rilindje (shek XIV – XVI) - zhvillimi i polifonisë dhe i shkollave polifonike; zhvillimi i muzikës instrumentale; lindja e operës - përfaqësuesit kryesorë. - periudhën barok dhe klasicizmi (shek. XVII dhe gjysma e parë e shek.XVIII) - muzika instrumentale, përfaqësuesit kryesorë. - Romantizëm, gjysma e dytë e shek. XVIII dhe gjysma e parë e shek. XIX – muzika vokale/ instrumentale - përfaqësuesit kryesorë. - shek. XX, zhvillimi dhe përfaqësuesit e saj. • të përshkruajë veçoritë e zhvillimit muzikor shqiptar (në lashtësi, mesjetë dhe shek. XIX –XX): <ul style="list-style-type: none"> - muzika ilire – figura e Niket Dardanit himnografi shqiptar; - muzika bizantine – Jan Kukuzeli dhe shkrimi muzikor; - muzika instrumentale dhe vokale shqiptare; • të analizojë një vepër muzikore, duke u mbështetur në disa kritere, si: <ul style="list-style-type: none"> - periudhën - kompozitorin - mjedisin social, shoqëror, politik, ku u krijua vepra - mesazhi që përcjell etj. • të analizojë pas dëgjimeve muzikore se si bashkëpunojnë <i>elementet e muzikës</i> në një vepër të caktuar muzikore; • të debatojë mbi një vepër muzikore, duke e nisur analizën nga përdorimi i elementeve muzikore; • të përcaktojë kronologjikisht, konceptualisht dhe tematikisht një vepër muzikore nga dëgjimi i saj:

	<ul style="list-style-type: none"> - <i>kronologjikisht</i>: barok, klasik, romantik, bashkëkohor, xhaz, muzikë popullore etj., - <i>konceptualisht</i>: muzikë orientale e ritmizuar, muzika e lartë ose e qetë, muzika për një tekst specifik. - <i>tematikisht</i>: muzikë festive, muzikë për kërcim, për film, patriotike dhe ajo që tregon histori; • të analizojë faktorët që ndikojnë në cilësinë e interpretimit të një vepre muzikore, nga një solist këngëtar/instrumentist apo nga orkestra të vogla ose të mëdha duke u ndalur te p.sh: intonacioni, cilësia e zërit, dinamika, artikulacioni, frazeologjia, ritmi etj.; • të ideojë vetë ose në grup, një projekt që ka të bëjë me zhvillimin historik muzikor të një stili, rryme apo gjinie të caktuar, si p.sh.: zhvillimi i muzikës operistike italiane nga lindja deri në ditët tona, vepra dhe përfaqësuesit kryesorë (p.sh.: biografi të kompozitorëve të kësaj periudhe, albume me foto, Cd me vepra më të mira të kësaj gjinie, artikuj kritikë etj.); • të diskutojë mbi ndikimin e muzikës te vetja dhe në shoqëri pa paragjykyar mendimet e të tjerëve, p.sh.: ndikimin e muzikës moderne etj.; • të marrë pjesë si pjesëmarrës apo organizator në veprimtari të ndryshme muzikore në klasë, shkollë, mjedisin ku jeton, komunitet dhe shoqëri; • të përshkruajë lloje të ndryshme të karrierës në muzikë, duke u mbështetur në llojin dhe nivelin e arsimimit e talentin, kushtet e punës, mundësitë e punësimit, pagën.
--	---

Linja 5: Teknologjia dhe media

Përshkrimi i linjës: Në këtë linjë nxënësit njihen me rolin që ka patur dhe ka zhvillimi teknologjik në muzikë (TV, CD, DVD, kompjuter etj.), apo pasurimi i skenës me mjete të reja sidomos në drejtim të *teknikës skenike, fonisë dhe ndriçimit*. Në këtë linjë studiohet roli i teknologjisë, por edhe ndikimet e saj. Gjithashtu, nxënësit do të studiojnë rolin e medias në lidhje me vetë muzikën dhe me artet e tjera, duke i bërë ata të ndjeshëm dhe duke i nxitur për të zhvilluar njohuritë dhe aftësitë përmes kësaj linje.

Orët e sugjeruara: 10

Linja	Objektiva
Teknologjia dhe media	<p>Në përfundim të këtij programi nxënës/i,-ja:</p> <ul style="list-style-type: none"> • të përshkruajë zhvillimin teknologjik dhe përdorimin e saj në muzikë (që nga aparaturat më të thjeshta e deri tek studiot muzikore, TV, reklamat, video klipet etj);

	<ul style="list-style-type: none"> • të përdorë programin e Finales dhe proceset fillestare paraprake të saj për shkrimin e notave muzikore: <ol style="list-style-type: none"> a. <i>setup</i> (hapja e finales), b. dokumentimi i faqes me emrin e pjesës/autorin/formatin A₃, A₄, A₅, c. përzgjedhja e instrumentit për shkrimin muzikor (piano, flaut), d. përcaktimi i tonalitetit, kohës dhe shenjave në armaturë, e. përcaktimi i tempit dhe i shkrimit viziv, hapja e partiturës dhe shkrimi i mendimit muzikor; • të prodhojë një CD apo tape recorder, si bazë muzikore me një tematike të caktuar për realizimin e një veprimtarie muzikore në shkollë; • të demonstrojë aftësitë si DJ, duke u bërë i dobishëm për shfaqje të ndryshme artistike në shkollë, komunitet etj.; • të përshkruajë <i>efektet muzikore negative</i> që mund të shkaktojnë edhe lëndime fizike (<i>zhurmat akustike në mjedise të mbyllura, si: në disko, pub etj.</i>); • të japë shfaqje për klasën, shkollën apo komunitetin si individ, apo grup muzikor; • të realizojë një projekt për realizimin e një shfaqjeje artistike, duke përshkruar <i>procesin dhe etapat artistike</i> që kalon një shfaqje muzikore nga ideimi deri në kontaktin me dëgjuesin (konsumatorin); • të promovojë një vepër artistike përmes përdorimit të mediave të ndryshme si: posterave, fletëpalosjeve, reklamave televizive etj.
--	--

4. KËRKESA TË MUZIKËS NDAJ LËNDËVE TË TJERA

MUZIKA	FIZIKA
Akustika Tingujt Drita, përthyerja e saj	Nxënës/i, -ja: <ul style="list-style-type: none"> ▪ të dallojë tingujt sipas karakteristikave të tyre; ▪ të bëjë dallimin ndërmjet tingullit dhe zhurmës; ▪ të zbatojë ligjet e pasqyrimin dhe përthyerjes së dritës; ▪ të përftojë ngjyrat nga mbivendosja e dritës me ngjyra të ndryshme për krijimin e efekteve skenike.
MUZIKA	HISTORI
Muzika në Rilindje	Nxënës/i, -ja: <ul style="list-style-type: none"> ▪ të përshkruajë ngjarjet historike, sociale dhe kulturore që lanë gjurmë në këtë periudhë.
Muzika në Romantizëm	<ul style="list-style-type: none"> ▪ të përshkruajë ngjarjet historike, sociale dhe kulturore që lanë gjurmë në këtë periudhë: Revolucioni Borgjez

5. KËRKESA PËR ZBATIMIN E PROGRAMIT

Ky program është një dokument zyrtar, pjesë e tërësisë së dokumenteve zyrtare për lëndën e muzikës. Dokumentet e tjera kryesore janë korniza kurrikulare e gjimnazit dhe standardet e fushës kurrikulare së arteve, ku kjo lëndë bën pjesë. Hartimi i programit është mbështetur si te korniza kurrikulare, ashtu edhe te standardet e fushës.

Për të siguruar përdorimin sa më të mirë të programit është e vlefshme njohja me dokumentet e lartpërmendura.

Te korniza kurrikulare vëmendje e veçantë i duhet kushtuar:

- Synimeve të përgjithshme të kurrikulës së gjimnazit;
- Synimeve të linjave ndërkurrikulare;
- Vlerësimin të nxënësit me notë;
- Parimeve të mësimdhënie-mësimnxënies.

Në mënyrë që tërësia e dokumenteve zyrtare (korniza kurrikulare, standardet e fushës së të nxënësve dhe programi lëndor) të zbatohen më së miri në dobi të nxënësve, përdoruesit e tyre duhet të njohin thellë programet lëndore të lëndës së muzikës për klasën paraardhëse dhe në vijim.

Gjithashtu, përdoruesve të këtyre dokumenteve u lind nevoja të njohin standardet e fushës së arteve dhe të të gjitha fushave të tjera të të nxënësve për të gjitha programet lëndore të të njëjtit vit.

Fusha e arteve vjen për herë të parë në **gjimnaz** në mënyrë të plotë përsa i përket kohës, përmbajtjes dhe strukturës, duke zhvilluar përmbajtjet e katër lëndëve të cilat janë: muzika, arti pamor, teatri dhe kërcimi. Studimi i dy prej këtyre lëndëve mund të jenë kombinimet: a) *muzikë – kërcim*, b) *art pamor – teatër*, apo edhe kombinime të tjera. Fusha e arteve për herë të parë ka një pamje të plotë, duke zhvilluar katër lëndë brenda saj me një përmbajtje të mjaftueshme kulturore për qëllimin që ka gjimnazi.

Muzika **në gjimnaz** studiohet në 54 orë mësimore, përkatësisht në 3 semestra me nga 1 orë në javë. Raporti i vëllimit midis njohurive dhe veprimtarive, në lëndën e muzikës është 60 me 40. Kurrikula e muzikës e konceptuar për gjimnazin do të thellojë dhe zgjerojë përvojat e fituara nga nxënësit në arsimin e detyruar, duke zhvilluar më tej aftësitë e të kuptuarit dhe të bërit muzikë. Programi i muzikës organizohet sipas linjave të përmbajtjes dhe për çdo linjë shënohen objektivat të cilat materializojnë elemente, njohuri muzikore, aftësi dhe qëndrime që pritet të fitojnë nxënësit gjatë studimit të këtij programi.

Ky program nuk kërkon që nxënësit të memorizojnë dhe riprodhojnë në mënyrë mekanike periudhat historike, veprat dhe përfaqësuesit e çdo periudhe, por të krahasojnë, të ngrenë hipoteza, të përshkruajnë dhe të mbajnë qëndrim kritik, duke vlerësuar opinionet e gjithsecilit. Linja e estetikës ndihmon nxënësit për të kuptuar të bukurën në art dhe në muzikë, për të argumentuar një vepër muzikore dhe pse kjo vepër për të është e bukur apo jo, duke përdorur një gjuhë të zgjedhur dhe të qartë artistikisht.

Për zhvillimin e kësaj lënde mësues/i, -ja punon vetëm dhe në grup, zhvillon biseda, konkurse, veprimtari artistike etj.

Zbatimi i programit duhet të bëhet duke respektuar parimet e barazisë gjinore, etnike, kulturore, racore dhe fetare.

Zhvillimi i të menduarit kritik për vlerësimin e një vepre muzikore.

Për të formuar dhe drejtuar në mënyrë të drejtë artistike dhe muzikore dijet e nxënësve për muzikën, duhet që mësues/i, -ja të drejtojë nxënësit, duke i njohur me hapat që duhet të kalojë analiza e një vepre muzikore: dëgjim, interpretim dhe vlerësim. Kjo gjë i bën nxënësit më të aftë jo vetëm për të njohur muzikë të llojeve të ndryshme, por edhe për të reaguar në mënyrë sa më profesionale ndaj saj.

Zhvillimi i qëndrimit kritik dhe aftësisë për të interpretuar në mënyrë artistike një vepër muzikore, është një nga detyrat e mësuesit. Në përdorimin e përditshëm termi “kritik” ka ngjyresën e një qëndrimi mosmiratues, kurse këtu, ka të bëjë me analizën, sintezën dhe vlerësimin si procese mendore tipike.

Pjesë e rëndësishme e të menduarit kritik është kujdesi i posaçëm dhe i përhershëm ndaj paragjytimeve vetjake ose të të tjerëve, anësisë, keqinformimit etj. Mësuesit duhet t’i japin mundësinë secilit nxënës që të kultivojë të menduarin kritik ndaj informacioneve, ngjarjeve, dukurive dhe qëndrimeve.

Edukimi i shprehive gjatë dëgjimit muzikor.

Zhvillimi i qëndrimit ndaj një vepre muzikore kërkon zhvillimin e aftësive dëgjimore. Për të formuar një kulturë të drejtë muzikore tek nxënësit, vëmendja e mësuesit përqendrohet te vlerat artistike të pjesëve të zgjedhura për dëgjim, të cilat të përkohjnë me periudhën kur është shkruar, apo gjininë për të cilën dëgjohet dhe flitet. Gjithashtu, këto pjesë muzikore duhet të plotësojnë kërkesat pedagogjike. Dëgjimi, si dhe kuptimi i një pjese muzikore, kërkon një përqendrim *më të madh* se sa i një kënge.

Për zhvillimin e kësaj ore, rol të rëndësishëm kanë mjetet didaktike mësimore dhe pajisjet, si: Cd, magnetofon që mundësojnë zbatimin me sukses të dëgjimit muzikor. Dëgjimet muzikore, të shoqëruara me *shpjegime* dhe *biseda në formë debati*, kanë rëndësi të madhe, sepse shtojnë më tej dhe përforcojnë njohuritë e muzikës. Rëndësi ka edhe përdorimi i pajisjeve, si p.sh.: kompjuter për shkrimin e notave, TV, video apo DVD.

Programi i muzikës kërkon nga zbatuesit që kjo lëndë të mos zhvillohet si një lëndë teorike, por si një lëndë praktike që zhvillon aftësitë *për të dëgjuar, gjykuar, vlerësuar dhe krijuar*.

Objektivat e programit

Objektivat e programit janë për të gjithë nxënësit. Kjo do të thotë se që të gjithë nxënësve duhet t’u jepet mundësia që të nxënë çka përshkruhet tek objektivat. Realizimi i objektivave në tema, kapituj, njësi dhe renditja e tyre është zgjedhje e lirë e zbatuesit të programit.

Orët e estetikës, pikërisht në objektivat me përmbajtje të përbashkët, realizohen në mënyrë të përbashkët për të dyja lëndët. Ndërsa objektivat që lidhen specifikisht me lëndën e zgjedhur do të shpjegohen dhe realizohen nga secila lëndë më vete. Orët e mbledhura për të dyja lëndët e përzgjedhura janë 10 orë, nga të cilat 4 orë janë për kuptimin e përgjithshëm të estetikës në të gjitha artet dhe 6 orët e mbetura do të ndahen sipas specifikeve estetike të lëndës së përzgjedhur (3+3).

P.sh.: Objektivi: “Të shpjegojë artet si pjesë e objektit të *estetikës*” kërkon që të gjithë nxënësit të njohin estetikën si një shkencë që studion artet dhe të përkufizojnë objektin e saj. Nëse një mësues nuk e bën këtë, nuk ka zbatuar programin lëndor.

Një objektiv përbushet në nivele të ndryshme nga nxënës të ndryshëm. Mësues/i, - ja dhe autorët e materialeve mësimore duhet të mbulojnë të gjithë gamën e niveleve të nxënësve.

P.sh.: Objektivi: “Të shpjegojë ndërtimin e formave të thjeshta 1, 2, 3 pjesësh dhe parimet e zhvillimit në gjini të ndryshme muzikore edhe gjatë dëgjimit” kërkon që të gjithë nxënësve t’u jepet mundësia për të shpjeguar *ndërtimin e formave të thjeshta 1,2,3 pjesësh* në mënyrë të sigurt, por jo nga të gjithë do të pretendohet i njëjti nivel i shpjegimit të këtyre formave.

Një tjetër nivel arritjeje është shpjegimi i *formave të thjeshta* në një dëgjim muzikor konkret të ngjashëm me shembujt e sapomësuar. Një nivel më i lartë se ky është se përdorimi i këtyre njohurive në situata të reja për nxënësin, por brenda njohurive të linjës së dhënë.

Një nivel edhe më i lartë do të ishte përdorimi dhe zbatimi në njohuritë e linjave të tjera të muzikës (historia e muzikës, bota dhe shoqëria), pastaj në një situatë të stimuluar dhe nga vetë bota reale.

Orët mësimore

Programi i muzikës është strukturuar në linja që vijnë njëra pas tjetrës, por nuk do të thotë se mësimdhënia-mësimnxënia duhet të zhvillohet në këtë renditje gjatë vitit shkollor.

Sasia e orëve mësimore për secilën linjë është rekomanduese. Përdoruesit e programit duhet të respektojnë sasinë e orëve vjetore të lëndës, por janë të lirë të ndryshojnë me 10% (shtesë ose pakësim) orët e rekomanduara për secilën linjë.

Domethënë, mësues/i, - ja mund të vendosë të vazhdojë më ngadalë kur vë re se nxënësit hasin vështirësi të veçanta në përbushjen e objektivave të linjës, por mund të ecë më shpejt kur nxënësit demonstrojnë një përvetësim të kënaqshëm.

Në programin e lëndës së muzikës afërsisht 60% e totalit të orëve mësimore janë për shtjellimin e njohurive të reja lëndore dhe 40% e tyre janë për përpunimin e njohurive (gjatë vitit dhe në fund të vitit shkollor).

Përpunimi i njohurive

Përpunimi i njohurive përmban:

- Përsëritjen brenda një linje të njohurive-bazë të tij (konceptet themelore);
- Integrimin e njohurive të reja të një linje me njohuritë e linjave paraardhëse;
- Integrimin e njohurive të reja me njohuritë e lëndëve të tjera brenda fushës së arteve dhe më tej (me fizikën, gjuhën, gjuhën e huaj etj.), (ndonëse këto integritime do të përshkojnë zhvillimin e çdo ore mësimore, gjatë përpunimit u duhet kushtuar kohë e posaçme);
- Përsëritjen vjetore (pavarësisht nga ndarja në linja, lënda duhet parë si një e tërë);
- Testimin vjetor (nuk është i detyruar).

Në orët mësimore, që i përkasin përpunimit të njohurive, mësuesi zhvillon edhe tema me nismën e tij ose me kërkesën e vetë nxënësve. Këto tema mund të pikënisjen nga ngjarje aktuale ose thjesht nga kureshtja e nxënësve.

Veçanërisht gjatë përpunimit të njohurive duhet t'i kushtohet kohë e posaçme kultivimit të:

Aftësive të posaçme lëndore:

Krijuese – shkrimin e një ese-je mbi një vepër të caktuar muzikore, duke sjellë një opinion dhe qëndrim të vetin;

komunikuese – komunikimin e saktë të njohurive, opinioneve, mendimeve dhe qëndrimeve të tyre rreth muzikës;

analizuese – analizimin e një vepre muzikore, përmes analizimit të elementeve muzikore nga e cila përbëhet një vepër, dhe që ndihmojnë për të patur një fjalor të saktë muzikor gjatë analizës së saj;

krahasuese – krahasimin dhe renditjen e karakteristikave të dy veprave muzikore të njëjta, por me kompozitorë të ndryshëm që i përkasin të njëjtës periudhë historike.

Formimit të qëndrimeve, si qëndrimi etiko-social etj., dhe gjatë punës në grupe të vogla nxënësish.

Gjatë orëve të përpunimit të njohurive, nxënësve duhet t'u krijohet mundësia për të punuar detyra tematike, si p.sh.: krijimi i një bazë muzikore, ese-je, projekte kurrikulare etj.

Një nga kërkesat për zbatimin me sukses të këtij programi është edhe zhvillimi i punës me nxënësit që mund të kenë vështirësi me dëgjim, aftësitë motorike të kufizuara për të punuar në kompjuter apo për të krijuar dhe demonstruar aftësitë si DJ etj. Kështu mësuesit të lëndës i del si detyrë lehtësimi i nxënësve nga këto procese, duke i kërkuar realizimin e detyrave që nuk përbëjnë problem fizik dhe emocional të tyre.

Por në këtë grup mund të hyjnë edhe nxënësit me vështirësi në të nxënë me të cilët mund të punohet veçmas, duke i ndihmuar ata të realizojnë detyrat dhe të arrijnë rezultate të kënaqshme.

Për realizimin e këtij programi sigurisht ka nevojë që mësues/i,-ja të evidentojë nxënësit e talentuar me aftësi të veçanta muzikore, duke përdorur metodat që i nxitin në zhvillimin e talentit të tyre.

6. VLERËSIMI

Vlerësimi i nxënësit përshkon gjithë procesin mësimor dhe shërben për përmirësimin e këtij procesi. Vlerësimi i nxënësit nuk ka për qëllim të vetëm vendosjen e notës dhe as nuk përfundon me vendosjen e saj.

Vlerësimi mbështetet tërësisht në objektivat programin lëndor dhe mësues/i,-ja nuk ka të drejtë të vlerësojë nxënësit për ato objektiva të arritjes që nuk përshkruhen në program.

Objektiv i vlerësimit nuk janë vetëm njohuritë dhe aftësitë, por edhe qëndrimet e nxënësve, si qëndrimet etiko-sociale në përgjithësi dhe ato të bashkëpunimit me të tjerët në veçanti.

Mësues/i,-ja zhvillon vetë, dhe në bashkëpunim me nxënësit, një larmi mënyrash vlerësimi, që kanë të bëjnë me analizën, interpretimin, vlerësimin e një vepre muzikore, shkrimin e një ese-je, krijimin e një baze muzikore për një shfaqje artistike etj.

Vlerësimi mund të bëhet individual ose në grup, në klasë ose jashtë saj. Nxënësi/ja vlerësohet me notë ndërsa demonstroi arritjet nëpërmjet veprimtarive e produkteve të ndryshme, si p.sh.: analizon një vepër muzikore dhe e interpreton qëndrimin e vet përmes një eseje; dëgjon një pjesë muzikore dhe bën krahasime me një vepër tjetër; merr pjesë në veprimtari të ndryshme artistike që organizon shkolla, duke marrë role të ndryshme në to etj.

Mësues/i,-ja nuk e ka të detyrueshëm vlerësimin me notë të nxënësve në çdo orë mësimore dhe të vendosë nota në regjistër për secilën orë mësimore. Si rregull, nxënësit dhe mësues/i,-ja duhet të bashkëbisedojnë lirshëm si partnerë rreth përvetësimin të njohurive të fituara gjatë orëve të kaluara dhe mirëkryerjes së eseve, kërkimeve në internet rreth një tematike të caktuar, rreth pjesëmarrjes në një veprimtari muzikore etj.

Herë pas here mësues/i,-ja duhet të vlerësojë me notë, duke ua bërë të qartë nxënësve që në fillim qëllimin e vlerësimit dhe kriteret e tij.

Portofoli i nxënësit, si një mundësi vlerësimi e vetëvlerësimi, është një koleksion i punimeve përgjatë vitit shkollor për një lëndë të caktuar. Ai mund të përmbajë detyra tematike (ese), organizime dhe projekte kurrikulare, prodhime të ndryshme të CD-ve, DVD-ve në dobi të veprimtarive të ndryshme shkollore, produkte të veprimtarive kurrikulare etj. Përzgjedhjet për portofolin bëhen nga nxënësit, ndërsa mësues/i,-ja rekomandon.